

MUHARREM DEZHGIU

**SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRI
(qershor – dhjetor 1943)**

Në gjysmën e dytë të vitit 1943 gjendja politike ushtarake e pushtuesit italian në Shqipëri, karakterizohej nga një krizë e gjithanshme, e cila kishte përfshirë të gjitha shtresat dhe forcat politike shqiptare. Rritja e qëndresës dhe rezistencës së shqiptarëve kundër pushtuesit, i kishte imponuar këtij të fundit, shtimin e dhunës ndaj shqiptarëve, si mjetin e vetëm për t'i nënshtruar. Situata e krijuar në ballafaqimin e shqiptarëve me pushtuesin, kishte çuar në kompaktësimin e shqiptarëve në një front antiitalian. Në këtë kuadër edhe forcat politike të rezistencës shqiptare, po shkonin drejt një bashkëpunimi midis tyre, për të realizuar detyrën themelore, të çlirimit të vendit. Por, pikërisht në këto rrethana të favorshme për luftën kundër pushtuesit, situata politike mori një drejtim që minoi bashkimin e shqiptarëve drejt një qëllimi të vetëm - çlirimin e vendit.

Shqyrtimi i ngjarjeve e proceseve historike në 6-mujorin e dytë të vitit 1943, përbën dhe objektin e këtij shkrimi.

*

* *

Në mesin e vitit 1943, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Shqipëri arriti një shkallë organizimi më të lartë. Ajo po orientohej drejt një bashkimi të vërtetë, në një front të vetëm luftime. Ishte kaluar nga faza e veprimit të çetave partizane në bashkimin e tyre dhe formimin e batalioneve. Nga muaji maj në korrik të vitit 1943, u formuan rreth 20 batalione në qarqet e Korçës, të Elbasanit, të Vlorës, të Beratit, të Shkodrës e të Dibrës. Numri i pjesëmarrësve në këto formacione u rrit në mënyrë të konsiderueshme, sidomos me formacionet vullnetare territoriale. Burim i rëndësishëm për shtimin e radhëve partizane u bënë nxënësit e shkollave të mesme, të cilët në shumë raste, braktisën, në mënyrë masive shkollat, siç ndodhi në Elbasan, në Korçë, në Vlorë etj.

Edhe Balli Kombëtar, si formacion tjetër politik i rezistencës shqiptare, ndërmoi veprime aktive, për t'iu përgjigjur detyrave për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të shqiptarëve. Drejtuesit e

kësaj organizate kishin kaluar në kushte ilegaliteti, gjë që kishte rënë në sy tek pushtuesi. Sipas një promemorie të pushtuesit, vihej në dukje se, ata kanë ndërtuar një qeveri ilegale*, në afërsi të Tiranës, në të cilën do të bënin pjesë të jashtëligjshmit Abaz Kupi e Myslim Peza, krerë të çetave të armatosura...¹. Përsosjen e organizimit ushtarak të Ballit Kombëtar “për realizimin e një kryengritjeje masive... gjatë fazës së fundit të disfatës së forcave të Boshtit”², e kishin konstatuar dhe misionet britanike që vepronin në Shqipëri.

Komiteti Qendror i Ballit Kombëtar formoi në verë të vitit 1943, dy komanda zonash: atë të Jugut dhe të Veriut³. Komanda e zonës së Jugut që përfshinte komandat e prefekturave të Elbasanit, të Gjirokastrës, të Vlorës dhe të Beratit, kishte në krye si komandant Hysni Lepenicën, i cili e vendosi qendrën në Berat.

Përpyekjet e forcave politike për mobilizimin e shqiptarëve, nëpërmjet përsosjes së formave të organizimit, shkaktuan frikë dhe panik tek pushtuesit. Krerët e lartë të regjimit të pushtimit deklarorin se “ndodhemi në gjendje shumë më kritike nga sa mund të duket. Nuk gjendemi përballë një organizate komuniste terroriste propagandistike, por gjendemi përballë një blloku që formon një front armik, i cili po përgatit, me siguri një front shumë të gjerë, mjaft të shpejtë dhe të organizuar mirë”⁴.

Vlerësimi i situatës nga autoritetet e larta të administratës së pushtuesit, ishte realist, sepse përputhej me zhvillimin e ngjarjeve politike në gjirin e forcave politike të rezistencës shqiptare. Po zhvilloheshin aksione të përbashkëta e të koordinuara në krahina të

* Është fjala për krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, organizëm për drejtimin e luftës, vendosur në Mbledhjen e Mukjes, 1 gusht 1943.

¹ *Ufficio Storico, Stato Maggiore Esercito Italiano* (më tej: *US.SMEI*) Diario Storico (DS), Anno 1943, B.2278, fasc.9. Promemoria, 8 gusht 1943.

² Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: SHB e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f. 95.

³ *Organizatrat tradhtare Balli Kombëtar e Legaliteti*, Tiranë: 1950, f.54. Ky botim me një titull tendencioz përmban fakte të pamohueshme për veprimtarinë e Ballit Kombëtar.

⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 252, Viti (më tej: V) 1943, Dosja (më tej: D.) 89, fl.5-6. Informacion i ministrit të Punëve të Brendshme, për Kryeministrinë dhe Mëkëmbësinë, 27 qershor 1943.

caktuara të vendit, ashtu siç bëheshin edhe e marrëveshje nga formacionet e organizuara krahinore, të këtyre forcave politike, partizane dhe balliste. Qëllimi i këtyre bisedimeve dhe marrëveshjeve lokale, ishte që të arrihej bashkëpunimi i organizuar i tyre në shkallë vendi kundër pushtuesit.

Armiku dallonte qartë në këto veprime e përpjekje për bashkëpunim midis forcave politike shqiptare, rrezikun që i vinte regjimit të tij. Togfjalëshi “front armik” i shprehur nga goja e pushtuesit dëshmonte, në mënyrë të dukshme krijimin e “frontit popullor shqiptar” kundër italianëve.

Vëmendja e pushtuesit ishte përqendruar në marrjen e masave përpara se të shpërthente një kryengritje masive e shqiptarëve. Për këtë arsye italianët organizuan operacione në disa zona të Shqipërisë gjatë muajit qershor 1943. Kështu, u zhvillua operacion spastrimi në zonën e Pezës, nga 13 deri 18 qershor 1943. Qëllimi i këtij operacioni, me raport forcash tepër të pabarabartë, ishte nënshtrimi i kësaj treve përfundimisht, para se të fillonte zbarkimi i ushtrive aleate në Ballkan, siç ishte propaganduar. Rezistenca dhe qëndresa që iu bë operacionit tregoi se tashmë pushtuesi “kishte të bënte me një popull që kishte vendosur të vdiste për të mbrojtur interesat e veta, nderin, atdheun dhe gjithçka”⁵.

Informacionet për një zbarkim të Aleatëve Antifashistë në Ballkan, i nxitën gjermanët dhe italianët, të bënin çvendosjen e forcave të tyre, nga brendësia e Shqipërisë në drejtim të bregdetit. Komanda gjermane deshi të vendoste edhe në Shqipëri një kontingjent forcash, por nuk u pranua nga Komanda Italiane e Lindjes. Ndërsa komanda italiane mori masa për lëvizjen drejt perëndimit të Shqipërisë të divizioneve “Parma”, “Firenze” dhe “Brenero”.

Ndërkohë, Divizioni I gjerman, i drejtuar për në rrethet e Janinës dhe Prevezës përshkoi itinerarin Manastir-Follorinë-Korçë-Ersekë-Janinë. Pararoja e e këtij divizioni u fut në kufirin shqiptar më 6 korrik 1943 në zonën e Korçës. Gjatë rrugës iu bë një pritë nga forcat partizane të krahinës së Kolonjës. Goditja e autokolonës së fuqishme gjermane pati si pasojë kryerjen e reprezaljeve të egra ndaj fshatrave më të afërm, Borovës dhe Barmashit. Fshati Borovë u dogj dhe u pushkatuan 107 veta, shumica e të cilëve ishin gra, fëmijë e pleq. Masakra e Borovës ishte pagëzimi i

⁵ Në AQSh ndodhen dokumente për operacionet në Pezë që ekzaltojnë luftimet e formacioneve shqiptare dhe mbështetjen e dhënë nga popullsia vendase.

parë i barbarisë naziste në tokën shqiptare. Më 8 korrik 1943, në rrugë e sipër, gjermanët dogjën Leskovikun. Nënprefekti i Ersekës raportonte për dëmet e mëdha të bëra nga ushtria gjermane, në të gjithë fshatrat 5 deri 10 km larg rrugës së kalimit⁶.

Gjatë rrugës së kalimit nëpër Shqipëri, nga Korça në urën e Peratit gjermanët vendosën posta ushtarake. Ndërsa, në fund të korrikut 1943, shtatmadhuria gjermane kishte miratuar planin e pushtimit të bregdetit shqiptar dhe dalmat, pa u shqetësuar për ndonjë kundërveprim të trupave italiane që e kontrollonin këtë bregdet. Brenda katër ditëve të para të gushtit 1943, Divizioni i 100-të gjerman u vendos në aerodromet e Shqipërisë pa gjetur asnjë kundërshtim serioz nga italianët.

Kalimi i gjermanëve nëpër Shqipëri dhe raprezaljet që bënë, prodhoi te shqiptarët akoma më tepër pakënaqësi dhe urrejtje ndaj italianëve, gjë që çoi në konfrontime të reja ushtarake. Autoritetet e xhandarmërisë së Korçës e vlerësonin rritjen e kësaj pakënaqësie si shkakun e forcimit të frontit antiitalian. “Nuk është aspak në interesin e qetësisë që të mbushen malet me ilegalë, sepse meshkujt e këtyre familjeve, duke mos mundur me i rezistue mjerimit, do të shtërngohen të reaksionojnë”⁷ (të përballen me regjimin – M.D.).

Situata e rënduar politike në Shqipëri e detyroi pushtuesin italian të merrte masa për riatdhesimin e familjeve të oficerëve për në Itali për të shmangur rrezikun e pasojave gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake. Në fund të qershorit numri i këtyre familjeve të riatdhesuara arriti në 1547 të tilla⁸.

Për të përballuar gjendjen e krijuar si rezultat i rritjes së pakënaqësisë së shqiptarëve, karabinieria italiane shtoi kontrollat personale e familjare. Si përgjigje e këtyre veprimeve, gjatë muajit korrik, pati largime masive e dezertime nga radhët e milicisë e të xhandarmërisë shqiptare, bashkë me armatimin dhe veshmbathjen që mbanin. Vetëm nga reparti i Regjimentit të dytë të gjuajtësve shqiptarë u larguan 21 oficerë, 30 nënoficerë dhe 540

⁶ *AQSH*, F.252, V.1943, D.89, fl. 5-6. Letër e nënprefektit të Ersekës për prefekturën e Korçës, nr. 61/14, 28 korrik 1943.

⁷ *Po aty*, F.254, V.1943, D.161, fl.76, Njoftim i Komandës së xhandarmërisë së qarkut të Korçës për Komandën e P. të Xhandarmërisë, 21 korrik 1943.

⁸ *US.SMEI*, DS, B.2278, V.1943, fasc.9. Informazioni al Comando Supremo su situazione in Albania del Renzo Dalmazzo, 22 giugno 1943.

ushtarë⁹. Duke e ndjerë se kjo “epidemi”, e largimit të efektivit të regjimentit të dytë, do të përhapej dhe në Regjimentin e tretë, komanda italiane vendosi çarmatimin e përnjëhershëm të tij, nëpërmjet largimit, gjoja me leje të posaçme. Pa pritur të zbatohet ky vendim, më 1 gusht, u larguan nga reparti 37 oficerë e 743 nënoficerë e ushtarë, duke ia prishur planin komandës italiane për çarmatimin e planifikuar¹⁰.

Oficerët shqiptarë, të bindur se Italia e kishte humbur tashmë luftën dhe do të detyrohej të kërkonte paqe të njëanshme, mendonin se, kishte ardhur çasti i përshtatshëm për veprim vendimtar kundër italianëve. Komanda italiane i cilësonte oficerët që organizuan dezertimet e reparteve të tyre, si eksponentë madhorë të lidhur totalisht me frontin kombëtar dhe që përgatisnin prej kohësh lëvizjen. Të tillë ishin: Neshat Kolonja, Fushet Dibra, Çauş Ali Basha, Dilaver Dinia, Gjon Koti etj.

Duke i klasifikuar oficerët në grupin e njerëzve të ditur, pra intelektualë, italianët arrinin në përfundimin se “dezertimet në masë ishin edhe një provë më shumë që, armiku më i keq i Italisë në Shqipëri, nuk është populli, por janë intelektualët”¹¹.

Rënia e qeverisë së Musolinit, më 25 korrik 1943, pati reflekse të drejtpërdrejta, të gjera dhe të thella, në të gjitha mjediset shqiptare. Situata e krijuar i kishte vënë në lëvizje të gjitha rrymat politike shqiptare që luftonin me forma e metoda të ndryshme Italinë. Tek italianët, ishte krijuar bindja se, “rezultante e luftës së rrymave të ndryshme ekstremiste do të ishte zbatimi i planit të kryengritjes së përgjithshme, largimi i Italisë nga jeta shoqërore shqiptare”¹².

Ky konstatim i ekspertëve politikë italianë për situatën e tyre në Shqipëri, ndonëse i hidhur për ta, ishte një realitet i dukshëm, shumë i qartë, sidomos në planin politik.

Prania e trupave gjermane në aerodrome apo në pika të ndryshme të bregdetit të Shqipërisë, kishte kompromentuar më tej prestigjin italian në sytë e shqiptarëve. “Disa shtresa të opinionit shoqëror kanë një simpati më të madhe për elementin gjerman se sa atë italian”¹³. Në rrethanat e

⁹ *Po aty*, Diserzioni nei regimenti “Cacciatori d’Albania” (Allegato nr. 6) mese di agosto.

¹⁰ *Po aty*, f. 2.

¹¹ *Po aty*. Elenco degli ufficiali albanesi che diserterano dal 2° e 3° Reg. “Cacciatori d’Albania” e dai rispettivi depositi ai primi di agosto 1943.

¹² *Po aty* (Allegato nr.6).

¹³ *Po aty*.

dobësimi të autoriteteve italiane, sipas vëzhgimeve të tyre, shqiptarët, mendonin për një aleat më të fuqishëm, për të siguruar mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë së bashkuar. Sigurisht, gjermanët që po vendoseshin në Shqipëri, konsideroheshin më të fortë se italianët.

Përballë kësaj situatë të vështirë ushtarake të italianëve e për rrjedhojë të përkeqësimit të rendit publik, kur ishte rritur së tepërmi pasiguria, morali i italianëve në Shqipëri ishte tronditur kudo.

Në situatën politike të Shqipërisë ishte vënë në rend të ditës krijimi i një shtabi ushtarako-politik, që të drejtonte e të koordinonte të gjitha forcat e rezistencës. Si i tillë, ai duhej të ishte një organizim përfaqësues në përbërje dhe t'u përgjigjej zhvillimeve politike e ushtarake në Shqipëri. Domosdoshmëria e krijimit të një shtabi të lartë, që të drejtonte luftën e shqiptarëve kundër pushtuesit, ishte shtruar që në Konferencën e Pezës. Realizimi i kësaj detyre, - siç ishte thënë atëherë - do të bëhej në procesin e luftës, kur të krijoheshin kushtet e përshtatshme. Këto kushte nënkuptonin, në radhë të parë, bashkimin politik të shqiptarëve në një front të organizuar. Bashkimi i organizuar politik i shqiptarëve u arrit në Mbledhjen e Mukjes (1-2 gusht 1943).

Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë që doli nga kjo mbledhje do të luante rolin e këtij Shtabi, do të drejtonte luftën e armatosur të të dyja forcave (LNÇL dhe BK), që ranë dakord për bashkimin e organizuar në luftë kundër pushtuesit. Detyra e Komitetit ishte për të organizuar, koordinuar e drejtuar luftën e formacioneve ushtarake (nën ndikimin e PKSh apo të Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar) deri në çlirimin e vendit.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH (10 korrik 1943) në prag të bisedimeve me Ballin Kombëtar, përbënte një veprim të njëanshëm të PKSH. Qëllimi i PKSH, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, ishte për t'iu imponuar palës tjetër (BK) në procesin e bisedimeve në Mukje, me një farë epërsie të saj në fushën e organizimit ushtarak. Nga ana tjetër, PKSH me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, pati dhe synime politike, për ta pasur këtë organizëm si armë në luftën për marrjen e pushtetit kundër forcave të tjera politike. Ndërkaq, propaganda komuniste e konsideronte formimin e Shtabit të Përgjithshëm si një shkallë e lartë organizimi ushtarak të ushtrisë partizane, për luftën kundër pushtuesit e bashkëpunëtorëve të tij. Ndërsa Balli Kombëtar, vetëm pas Mbledhjes së

Mukjes, krijoi një Komision Ushtarak¹⁴, si një organizëm që do të realizonte strategjinë dhe taktikën më të përshtatshme për bashkëpunimin me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Në lidhje me këtë bashkëpunim, mbi bazën e marrëveshjes së arritur në Mukje, Komiteti Qendror i Ballit Kombëtar udhëzonte: “Në vendet ku janë çeta të tjera që s’janë të Ballit Kombëtar, po që luftojnë okupatorin, çetat katundare (të Ballit – M.D.) duhet të ndihmojnë si njerën dhe tjetrën anë”¹⁵. Vetëm duke vepruar në këtë mënyrë do të realizohej misioni i Marrëveshjes së Mukjes, për bashkëpunim të shqiptarëve në një front të vërtetë lufte.

Vetë pushtuesi italian, në fillim të muajit gusht 1943, e vlerësonte qëndresën e shqiptarëve ndaj tij si “një lëvizje e përgjithshme revolte, e përhapur në gjithë Shqipërinë me manifestime të ndryshme sipas kushteve e zonave”¹⁶. Italianët tashmë nuk bënë diferencime midis shqiptarëve, por shprehnin hapur mosbesimin ndaj tyre, duke bërë një farë vetëqortimi, se ata (italianët) ishin treguar dritëshkurtër ndaj shqiptarëve. Italianët ishin zhgënjyer, duke menduar se “shqiptarët u zgjasin dorën italianëve por në momentin e mirë (të përshtatshëm) u japin atyre stërkamsin”¹⁷.

Duke ardhur në këtë përfundim, pushtuesi italian konfirmonte dështimin e plotë të të gjitha planeve e projekteve që u orvat të zbatonte në Shqipëri, për bashkimin e dy popujve e të të dy vendeve. Edhe ato individë apo grupime që italianët i kishin pandehur si mbështetje për ushtrimin e pushtetit të tyre në Shqipëri, në fund të fundit, u bashkuan me frontin antiitalian. Komanda e Armatës 9-të të ushtrisë italiane në Shqipëri pronte me dhimbje të madhe faktin se, “popullsia shqiptare në shumicën e saj e pa dallim klase, ishte kundërshtarë e Italisë dhe kundër qëndrimit të trupave tona në Shqipëri”¹⁸.

Fenomeni i largimit nga detyra u përhap jo vetëm në radhët e ushtarëve shqiptarë, por edhe në radhët e shtresave të tjera të shoqërisë shqiptare. Qëndrimin e hapur antiitalian e shpalosën dhe klerikë atdhetarë që kishin një ndikim të fuqishëm tek besimtarët, siç ishte shembulli i

¹⁴ AQSH, F.270, V.1943, D.1, fl.4. Udhëzime të KQ të Ballit Kombëtar, 15 gusht 1943.

¹⁵ *Po aty*, f.5.

¹⁶ *US.SMEI*, DS, B.2278, V.1943, fasc.9. Notiziarie mensile nr.8 della Comanda 9^a Armata, Ufficio I, (mese di agosto 1943).

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

françeskanit Lek Luli. Pas lirimit nga internimi, me propagandën e zjarrtë në ambientet katolike, Lek Luli ishte bërë kundërshtar i ashpër i italianëve. Duke iu referuar qëndrimit të tij, Ymer Dishnica pohonte: “Me Patër Lek Lulin u poqëm këto ditë jashtë Tiranës. Të gjithë mbetën të kënaqur. E gjetëm me të vërtetë një patriot të flaktë ... Aderon pa rezerva në platformën e Pezës (bashkim pa dallim feje, krahine apo ideje – M.D.) mik i ngushtë i Bazit (Abaz Kupit) i Xhemal Herrit dhe i Tafarit (Mustafa Gjinishit)¹⁹. Edhe prifti Zef Shestani, i katedrales së Shkodrës “hidhte gurë” mbi shpirtin e besimtarëve, duke propaganduar ide revolucionare kundër Italisë etj.

Ngjarjet në Shkodër kishin krijuar për italianët një situatë delikate “për të prodhuar befasi të dhimbshme, ku edhe një ndërhyrje energjike nuk do t’i shkulte rrënjët e turbullirës”²⁰.

Gjatë muajit gusht 1943, në ditët e agonisë së fundit të tyre në Shqipëri, italianët u treguan të ashpër në operacionet e Matit dhe të Dibrës, duke mobilizuar forca të shumta kundër forcave kryengritëse të këtyre krahinave.

Pas Kuvendit të Bruçit (në Mat), më 26 korrik 1943, forcat nacionaliste dhe partizane të krahinës, organizuan sulmin e përbashkët kundër forcave italiane në Burrel dhe në German (afër Burrelit). Forcat e çetave të armatosura të krahinës, sipas vlerësimit të italianëve, arrinin rreth 1500 burra²¹ dhe sipas burimeve shqiptare rreth 3000 veta²². Për të bërë çbllokimin e garnizoneve të mësipërme të rrethuara, u dërguan në drejtim të Burrelit dy autokolona me forca italiane. Kolona italiane e nisur nga Kruja u gozhdua në Qafë –Shtamë, në pritën e organizuar nga forcat nacionaliste e partizane të Matit, Krujës dhe Tiranës, të drejtuara nga Abaz Kupi, ish-pjesëmarrës në Mbledhjen e Mukjes dhe komandant operativ në këto luftime.

Forcat kryengritëse shqiptare, peshën kryesore të të cilëve e kishin matjanët, patën 33 të vdekur. Sipas italianëve, mund të ishin 100. Ndërsa

¹⁹ *AQSH/Arkivi i Partisë* (më tej: *AP*), F.14, V.1943, D.21. Letër e Ymer Dishnicës drejtuar Enver Hoxhës, 19 korrik 1943.

²⁰ *US.SMEI*, DS, B.2278, V.1943, fasc. 9. Notiziario mensile agosto 1943.

²¹ *Po aty*, Anno 1943. Notiziario mensile. Operazioni del Mati.

²² *Historia e Luftës Antifashiste të popullit shqiptar*, Vëll.3, Tiranë: “8 Nëntori”, 1988, f. 377.

nga forcat italiane kishte pasur 19 të vdekur (midis të cilëve 2 oficerë), 49 të plagosur e 7 të humbur²³.

Luftimet e Qafë-Shtamës patën një rëndësi të veçantë. Ishin veprimet e para të suksesshme të përbashkëta të forcave të rezistencës shqiptare, në zbatim të Marrëveshjes së Mukjes. Abaz Kupi, që drejtoi luftimet, veproi me guxim e vendosmëri, për të treguar dhe vlerën e marrëveshjes së arritur midis forcave politike në Mukje. Disa ditë përpara kësaj ngjarjeje shtypi ilegal i luftës do të shkruante: “Bazi i Canës (kështu quhej Abaz Kupi – M.D.) mendimet e tij i realizon në fushën e luftës dhe solidar deri në vdekje, me gjithë patriotët e tjerë shqiptarë, u hodh në luftën nacionalçlirimtare. Një luftë për një atdhe”²⁴. Ashtu si në 1939, Abaz Kupi vazhdonte luftën e tij me të njëjtin objektiv: luftë për çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Në kryengritjen popullore të Matit, Abaz Kupi jo vetëm nuk sabotoi, siç është shprehur ndonjë bashkëkohës²⁵, por dha shembullin se si duhej të luftohej, duke bashkëpunuar me të gjitha forcat atdhetare, që donin çlirimin e vendit.

Forcat italiane të Divizionit “Firence” gjatë kalimit nga Dibra në drejtim të perëndimit të Shqipërisë, u ndeshën në zonën e Dibrës me forcat kryengritëse dibrane e matjane, nga 2 gushti deri më 26 gusht 1943.

Pushtuesi italian, i tronditur thellë nga kryengritja e Matit, bëri djegie e raprezalje masive. Rreth 19 fshatra u shkrumbuan nga forcat italiane, si hakmarrje për qëndrimin e vendosur antifashist të matjanëve. Lufta e matjanëve, gjatë muajit gusht 1943, së bashku me luftën e Reçit (në Shkodër), përbëjnë një pikë kulmore të konfrontimit ushtarak italo-shqiptar, në prag të kapitullimit të Italisë. Mbi të gjitha, kryengritja popullore e Matit ishte provë e suksesshme e bashkëpunimit të të gjitha forcave politike shqiptare.

Pushtuesi italian u kushtoi rëndësi të veçantë ngjarjeve në Mat e Dibër, duke i konsideruar ato si, “çelësin e përhershëm të mbrojtjes së

²³ *US.SMEI*, DS, Anno 1943. Notiziario mensile nr.8. Operazioni del Mati (mese di agosto) pag.11. Riepilogo perdite avversarie e nostre (Alleg. Nr.2).

²⁴ *Zëri i Popullit*, nr. 13-14, viti 1943. “Bazi i Canes, Myslim Peza, Baba Faja i Martaneshit” tre emra patriotësh të Luftës Nacionalçlirimtare.

²⁵ Beqir Minxhozi, *Lufta Nacionalçlirimtare në Mat*, (Kujtime), Tiranë: “Iliar”, 2000, f. 114.

Shqipërisë”²⁶, gjë që e shtrëngoi Komandën e Korpormatës italiane të përqendronte në rajonin e Matit e të Dibrës një divizion të tërë.

Madhështia e kryengritjes popullore të Matit është zbehur si rezultat i vlerësimit të saj vetëm nga pozita tendencioze politike. Ajo është shfrytëzuar për kapital politik, sipas momentit e koniunkturave të caktuara, si rrjedhojë e modelimit të vijës politike të PKS, pas denoncimit të Marrëveshjes së Mukjes²⁷.

Gjatë muajit gusht 1943, ushtria italiane hyri në luftime të detyrueshme kundër forcave kryengritëse shqiptare pothuajse në tërë vendin. Ajo përballoi më tepër se një sulm në ditë, të organizuar nga forcat kryengritëse²⁸. Forcat kryengritëse shqiptare patën humbje të shumta, sidomos në Libohovë (17 vetë), në Qafën e Llogarasë (30 vetë), në Berat (100 vetë), në zonën e Suçit (30 vetë)²⁹. Rezultati përfundimtar, për luftimet e zhvilluara gjatë muajit gusht 1943, ishte për italianët 46 të vrarë dhe të zhdukur si dhe 78 të plagosur, ndërsa, italianët pohojnë se nga forcat kryengritëse shqiptare numri i të vrarëve arrinte në 274 vetë³⁰.

Pushtuesi fashist e kishte evidentuar qartë përbërjen e forcave shqiptare, organizimin dhe drejtuesit e këtyre formacioneve³¹. Nga përlllogaritjet e bëra të dhënave që kanë këto dokumente del se, kundër forcave italiane të pushtimit numri i kryengritësve shqiptarë ishte afërsisht 22.970 vetë³².

Në fund të muajit gusht 1943, forcat italiane, në Shqipëri arrinin gjithsej 108.000 veta³³ ose një e gjashta e të gjitha forcave italiane në rajonin e Ballkanit. Numri më i rritur i forcave italiane, të dislokuara në

²⁶ *US.SMEI*, DS, Anno 1943, B.2278, fasc.9. Comanda della Armata, Ufficio I, Notiziario mensile nr.8 (mese di agosto), p.3.

²⁷ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë: “Mësonjëtorja” 2005, f. 397-398.

²⁸ *US.SMEI*, DS, Anno1943, B.2278, fasc.9. Specchio delle agresioni e dei conflitti verificatisi durante il mese di agosto (Allegate, nr.1).

²⁹ *Po aty*. Shih tabelën përkatëse.

³⁰ *Po aty*. Përlllogaritjet janë bërë nga autori, mbështetur në pasqyrën e dhënë nga Komanda e Korpormatës 9-të italiane.

³¹ *Po aty*. Nominativi dei capi delle forze ribeli dislocate in Albania (allegate nr.9) mese di agosto.

³² *Po aty*. Përlllogaritja është bërë nga autori në bazë të pasqyrës së dhënë nga komanda italiane.

³³ *US.SMEI*, DS, B.3004, Anno 1943, fasc. 6. Dati complessivi sulle situazione operativa e logistica in Balkania ed Egeo al 1 agosto 1943.

Shqipëri, në krahasim me ato të muajit qershor, tregonte për një angazhim më të madh në veprime luftarake të forcave italiane kundër shqiptarëve. Ndërsa materialet logjistike për muajin gusht ishin më të vogla se ato të muajit qershor³⁴, gjë që tregonte rënie të potencialit luftarak italian, si rezultat i zbarkimit të forcave aleate në Jug të Italisë. Një situatë e tillë ishte preludi i kapitullimit të Italisë fashiste në Luftën e Dytë Botërore.

Përveç përpjekjeve për të forcuar pozitat ushtarake në Shqipëri, administrata italiane i kushtoi vëmendje dhe veprimet politik. Mëkëmbësi i Mbretit në Shqipëri, Pariani, duke iu referuar rolit të Shqipërisë për synimet politike italiane në Ballkan, do të theksonte se “Shqipëria deri tani ka përfaqësuar themelin e politikës tonë në Ballkan, si kryeurë për depërtim politik-ekonomik në Mesdheun Lindor”³⁵. “Prandaj, - vazhdonte ai, - Shqipëria ka përfaqësuar, përfaqëson dhe do të përfaqësojë një interes italian”.

Nisur nga këto qëllime strategjike ndaj Shqipërisë, Mëkëmbësi i Mbretit shtronte nevojën që Italia do të duhej të përballej me problemin se si duhej paraqitur Shqipëria në kohën e duhur, në tratativat e paqes. Me fjalë të tjera, Italia kishte filluar të mendonte për të ruajtur interesat e saj në Shqipëri edhe pas përfundimit të luftës.

Por italianët nuk e fshihnin faktin se, në ato momente, qoftë për efekt të reaksionit qoftë për përshtatje me situatën e përgjithshme “pothuajse të gjithë shqiptarët tregohen - mbase më shumë për oportunitet se për bindje personale – në mënyrë të qartë antiitalianë”³⁶. Megjithatë, në planet politike të Italisë shtrohej problemi për një përfaqësim të Shqipërisë në Konferencën e Paqes, nga njerëz të pozicionuar si antiitalianë. Kështu do të shpëtoheshin interesat jetësore për rimarrjen e veprimit politik-ekonomik të Italisë në Ballkanin e pasluftës. Në këtë kuadër, Mëkëmbësi i Mbretit italian në Tiranë njoftonte ministrin e Jashtëm se kishte ngarkuar një komision të përbërë nga Mustafa Kruja, Dhimitër Berati, Vasil Avrami, Dhimitër Popa e Fuad Asllani, që të studionin reformimin e Statutit dhe të ligjeve të tjera themelore të shtetit, për t’ia përshtatur këto akte situatës së re dhe ata të ishin të pajtueshëm

³⁴ *Po aty*, 9 Armata (Albania) Situazione logistica.

³⁵ *Documenti Diplomatici Italiani* (DDI), Nona serie 1939-1943, vol. I, dok. 653, Il Luogotenente del Re in Albania, Pariani, Al ministro degli Esteri, Guariglia, Tirana, 12 agosto 1943, f. 826.

³⁶ *Po aty*, f. 828.

me dëshirat e karakterin kombëtar të shqiptarëve në lidhje të ngushtë me Italinë.

Krahas këtij komisioni që do të bënte përshtatjen e Statutit me interesat kombëtare të shqiptarëve, Mëkëmbësi i Mbretit kishte pritur në Romë ish ministrin shqiptar Mehdi Frashëri, i njohur si kundërshtar i pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Qëllimi i këtij takimi ishte që pavarësisht nga situata e dominuar qartë prej autoritetit ushtarak, të mbahej parasysh që tani rrethana e studimit, se si Shqipëria do të duhej paraqitur në konferencën e ardhshme të paqes, për me dalë prej saj në kushtet më të mira të mundshme, si për vete, ashtu edhe për raportet e ardhshme midis dy vendeve³⁷. Pikërisht për këtë çështje iu kërkua opinionimi Mehdi Frashërit. Ky i fundit duke bërë një përmbledhje të jetës së tij politike, kredon e tij e mbështeti në tre nyje kryesore:

- 1) Bindje për nevojën (historike, gjeografike, ekonomike) për një bashkëpunim të ngushtë italo-shqiptar
- 2) Mbështetje për një aleancë italo-shqiptare
- 3) Kundërshtar i vendosur për pushtimin italian.

Mbështetur në këtë kredo politike të tij, Mehdi Frashëri u tregua i gatshëm për një bashkëpunim. Pra, ai mbante pikëpamjen se “vetëm një përfaqësim shqiptar që i përgjigjej këtij parimi, mund të ishte i pritur në Shqipëri dhe të ngarkohej të mbështeste tezat shqiptare, në tratativat për paqe³⁸”.

Me sa dukej, shqetësimi më i madh për Mehdi Frashërin ishte rreziku që i vinte Shqipërisë nga fqinjët e saj. Ndaj ai shtronte dhe nevojën e ngritjes së një Komiteti, i cili të vihej në krye të një lëvizjeje kombëtare dhe nga ky Komitet do të dilnin elementët që do të duhej të përfaqësonin Shqipërinë në Konferencën e Paqes, duke llogaritur tendencat dhe aspiratat shqiptare, në kundërshtim me pangopësinë greke e serbe. Një gjë e tillë nuk u pranua nga Mëkëmbësi Pariani, me arsyetimin se, në këtë kohë lufte nuk mund të lejoheshin vatra të qëndresës shqiptare që do të mund të determinonin situatën.

Në përgjigjen që ministri i Jashtëm italian, Guariglia, i drejtonte Parianit, mbi bisedimet e këtij të fundit me Mehdi Frashërin, vinte në dukje se “Shqipëria do të duhej të përfaqësonte për Italinë një faktor për mbrojtje [strategjike] dhe prandaj duhej një strukturë politike që të

³⁷ *Po aty*, dok. 660. Tiranë, 13 gusht 1943.

³⁸ *Po aty*, f. 834.

konsolidonte karakterin e kombit dhe të shtetit, që të ketë në vëmendje nxitjen e Greqisë e të sllavëve drejt Adriatikut në funksion të pashmangshëm antiitalian”³⁹. Më tej, ministri i Jashtëm sqaronte se shtrohej qartësisht problemi i pavarësisë së Shqipërisë dhe forcimi i saj si shtet për të cilin Italia, logjikisht dhe sinqerisht, nuk mund të mos ndjejë për vetë interesat e saj. Duke pohuar se, Italia është i vetmi vend që ka një interes real për ekzistencën e Shqipërisë dhe për konsolidimin e saj pa qëllime të fshehta, arrinte në përfundimin se, “Interesat politike, kulturore dhe ekonomike, sigurisht të bazuara mbi të njëjtin realitet gjeografik, çojnë dhe do të çojnë të dy vendet për bashkëpunim në çdo fushë, duke i bashkuar kundër rreziqeve dhe kundërshtarëve të përbashkët”⁴⁰.

Duket qartë se në atë kohë, interesi italian ishte që Shqipëria të paraqitej në selinë e organizmit evropian të pasluftës, si një entitet etnik e politik, i kolauduar përmes ngjarjeve e vështirësive të periudhës së luftës, për të evituar ndarjen e territorit të saj midis shteteve kufitare, armiq të tij tradicionalë. Ministri i Jashtëm e mbështeti nismën e Mëkëmbësit për ngritjen e Komisionit që do të përshtaste statutin me njohjen e aspiratave politike të nacionalistëve. Ndërsa, sa i përkiste propozimit të Mehdi Frashërit për ngritjen e një komiteti në krye të një lëvizjeje kombëtare, ministri shprehej për një qëndrim të kushtëzuar:

1) që vetë Komiteti të mos bënte asgjë kundër sigurisë ushtarake italiane në Shqipëri

2) që personi Frashëri të mos dërgohej tani në Shqipëri, duke u drejtuar prej Italisë vetë lëvizja.

Pavarësisht nga këto kushte që vinte ministri i Jashtëm italian për ta shfrytëzuar autoritetin e Mehdi Frashërit si nacionalist, ai kishte bindjen se organizata që propozonte M.Frashëri do t'i jepte dorë organizimit të një lëvizjeje që përfundimisht do të largonte Italinë nga Shqipëria.

Politika italiane e konsideronte të rëndësishme krijimin e një organizimi nacionalist të karakterit politik që në çastin e përshtatshëm, të merrte drejtimin e atij institucioni i cili do të ishte shteti i ri shqiptar. Politika italiane synonte që krahas veprimet energjik të forcave ushtarake italiane kundër dhunës nga ana e rebelëve, do të duhej të tolerohej

³⁹ *Po aty*, dok. 685. Il ministro degli Esteri Guariglia, al Luogotenente del Re in Albania, Pariani, Roma, 19 agosto 1943, f. 860.

⁴⁰ *Po aty*.

veprimi politik për grumbullimin, rreth një komiteti kombëtar të rrymave të ndryshme, që do të konkurronin për formimin e Shqipërisë së nesërme.

Në fund të gushtit 1943, situata në Shqipëri e detyroi politikën italiane të bënte kalimin, brenda një kohe të shkurtër, të pushtetit civil tek autoriteti ushtarak. Pritej të propozohej personi që të hynte në lidhje me gjeneral Dalmazzon, për kalimin e pushtetit tek autoriteti ushtarak⁴¹. Në fillim të shtatorit 1943, pas bisedës që kishte zhvilluar Mehdi Frashëri me ministrin e Jashtëm të Italisë, kryetari i Zyrës për Shqipërinë Nonis konfirmonte se “aktualisht Shqipëria është paraprakisht një sektor ushtarak, në kuadrin e së cilës shtrohen kërkesat e luftës. Nuk ishte koha e ndryshimit të rreshtimit luftarak, sepse ekzistonte një lëvizjeje politike lokale me përpjesëtime të gjera, me funksion efektiv antiitalian, pra, me rrjedhoja të drejtpërdrejta për forcat e armatosura të dislokuara atje”⁴².

Në letrën që Mehdi Frashëri i dërgonte ministrit të Jashtëm italian, Guariglia, i bënte një analizë gjendjes politike në Shqipëri, ku theksonte që “Aktualisht mbretëria është në anarki të plotë dhe çorganizimi ka përfshirë gjithë krahët e administratës. Kjo situatë i kishte dhënë mbështetje propagandës së huaj (antiitaliane) që ajo të gjente terren të favorshëm. Marrëdhëniet e mira të ardhshme brenda dy popujve të bregdetit Adriatik janë të kompromentuara nga dita në ditë.

Në këto rrethana të zhvillimit të ngjarjeve, sipas Frashërit, për ushtrinë italiane në Shqipëri kishte dy rrugë: a) të vazhdonte luftën në kushte të disfavourshme ose 2) të preferonte paqen e njëanshme⁴³.

Në rastin e parë, Shqipëria do të zhytej në kaos dhe në anarki. Në rastin e dytë ushtria shqiptare do të çarmatosej prej aleatëve për më tepër prej ushtrisë greke dhe serbe. Kjo do ta vinte Shqipërinë në një situatë më të keqe. Vetëm në një rast tërheqje graduale të Italisë do t'i linte vendin krijimit të një qeverie vendase, që do të zinte vendin e autoriteteve italiane. Qeveria shqiptare do të vendoste qetësinë dhe sigurinë publike të vendit, duke shfrytëzuar krijimin e një xhandarmërie dhe një ushtrie të vogël. Ajo do të përgatitej për konferencën e ardhshme të paqes.

⁴¹ *Po aty*, dok.736, Ministro degli Esteri, Guariglia al Capo di Stato Maggiore Generale, Ambrosio, Roma, 30 agosto 1943, f. 899.

⁴² *Po aty*, dok. 747. Il capo del refficia Albania Nonis al Segretaria Generale agli Esteri, Rosso Roma, 1 settembre 1943, f. 910.

⁴³ *Po aty*, dos. 747. Allegato. L'ex-presidente del Consiglio d'Albania, Mehdi Frashëri, al ministro degli Esteri, Guariglia, Roma, 30 agosto 1943, f. 911.

Tensionimi dhe acarimi i situatës politike në Shqipëri e orientonte politikën italiane të bënte lëvizje në qëndrimet e saj. Edhe pse ishin të bindur se “shqiptarët ishin gjithmonë e më të lodhur prej italianëve, megjithatë ata vlerësonin se “Komunistët dhe nacionalistët të dy palët të papajtuëshëm, kryejnë përpjekje të vazhdueshme për të arritur drejt një qëllimi dhe të bashkohen në veprimin kundër pushtuesit, por që deri tani nuk ja kanë dalë mbanë veç disa marrëveshjeve të pjesshme”⁴⁴.

Megjithatë, në fund të fundit mendimet e sugjerimet e bëra nga nacionalistët shqiptarë si Mehdi Frashëri, u morën në konsideratë nga italianët që të vepronin. Pariani kishte ngritur Komisionin për studimin e Statutit i përbërë nga Kruja dhe Berati (Dhimitër) me detyrë: të rishikonin Statutin dhe ligjet e tjera themelore të shtetit, për t’i vënë në harmoni me anulimin e regjimit fashist dhe zgjerimin e veprimit të Statutit, në mënyrë që, të përfshihej në studim aspirata kombëtare shqiptare. Me fjalë të tjera, qëllimi i këtij studimi të ishte një program kombëtar rreth të cilit të grumbullohej masa më e madhe e mundshme e shqiptarëve e kështu të mund të ndërtohej një organizëm etnik, kompakt, i cili të mund të paraqitej në Kongresin që do të rregullonte fatin e shteteve dhe të kombeve evropiane, në fund të luftës.

Ky komision kishte ndërmarrë biseda me nacionalistë të njohur të Shqipërisë së Veriut, të cilët kishin premtuar bashkëpunimin në drejtimin e dëshiruar.

Mehdi Frashëri, nëpërmjet kreut të zyrës italiane për Shqipërinë, kishte falënderuar ministrin e Jashtëm italian, për mirëkuptimin që kishte gjetur me të, që Shqipëria të orientohej për një pavarësi të plotë⁴⁵. Më tej, Frashëri e kishte zhvilluar idenë e vet në këtë drejtim që, “trupat italiane të përqendrohen e të përforcohen gjatë bregdetit shqiptar, ndërsa ato gjermane do të mbanin kufirin në brendësi, për t’iu kundërvënë presionit grek e serb”⁴⁶. Midis këtyre dy vijave do të mbetej një zonë në të cilën shqiptarët të lireshin të lirë të bashkoheshin dhe të organizoheshin, për të përgatitur strukturën e shtetit të ri shqiptar i cili

⁴⁴ *Po aty*, dok. 753. Il Luogotenente del Re in Albania, Pariani al ministro degli Esteri, Guariglia, Tirana, 2 settembre 1943, f. 916.

⁴⁵ *Po aty*, dok. 747. Il capo del Ufficio Albania Nonis, al Segretario Generale agli Esteri, Rosso, Roma, 1 settembre 1943, f. 910.

⁴⁶ *Po aty*, dok. 759. Il Segretario Generale agli Esteri Rosso, al Ministero degli Esteri, Guariglia, Roma, 3 settembre 1943, f. 921.

(edhe për arsye interesash) me siguri do të orientohej në drejtimin e favorshëm për Italinë.

Në këtë situatë të gjendjes në Shqipëri, Italia po ndryshonte politikën e qëndrimit ndaj saj. Por koha nuk premtonte për realizimin e kësaj politike. Në Ministrinë e Jashtme të Italisë kishin ardhur njoftimet, sipas të cilave komanda gjermane kishte përgatitur hyrjen e trupave gjermane në Shqipëri⁴⁷. Pas formimit të Korpusit XXI, ishte në formim e sipër një korpus tjetër, në të cilët do të bënin pjesë edhe specialistë të çështjes shqiptare si Hansdig etj. Si pretekst për të kaluar kufirin në drejtim të Shqipërisë do të sajohet nevoja e burimeve logjistike të Kosovës.

Tratativat që bëri Mehdi Frashëri me përfaqësues të politikës italiane, për ta orientuar qëndrimin e saj për bashkëpunim me Shqipërinë e pasluftës, nuk u realizuan pasi ngjarjet kishin patur zhvillime të vrullshme që çuan në kapitullimin e Italisë. Kredon e vet politike për të krijuar një organizëm shtetëror në Shqipëri, që do të mbronte pavarësinë, në fund të Luftës Botërore, Mehdi Frashëri u përpoq ta zgjidhte në koordinim me forcat gjermane të vendosura në Shqipëri.

Marrëveshjet lokale të arritura gjatë gjysmës së parë të vitit 1943, ndërmjet organizmave dhe formacioneve të rezistencës shqiptare, të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe Ballit Kombëtar, u finalizuan me Mbledhjen e Mukjes, 1-2 gusht 1943

Gjithçka u arrit në Mbledhjen e Mukjes iu bë e njohur popullit shqiptar me një proklamatë të nënshkruar nga Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë⁴⁸.

Mbledhja e Mukjes shkaktoi shqetësim të madh në radhët e pushtesit, Me dekret të Mëkëmbësisë së Përgjithshme u pushuan nga puna Faik Quku, Jup Kazazi, Ethem Haxhiademi, Sulejman Meço, Halil Mëniku, sepse kishin tradhtuar detyrën⁴⁹.

Duke iu referuar situatës në Shqipëri dhe i alarmuar nga vendimet e Mukjes, pushtuesi italian e konsideronte këtë mbledhje “një bashkim kombëtar që kishte si program përzënien e italianëve nga Shqipëria”⁵⁰.

⁴⁷ *Po aty*, dok. 751, Il ministro a Belgrado, Grazi, al ministro degli Esteri, Guariglia, Belgrado, 2 settembre 1943, f. 915.

⁴⁸ *AQSH/AP*, F.270/1, V.1943, D.5. Proklamatë, gusht 1943.

⁴⁹ *Po aty*, F.270, V.1943, D.1943, fl.4. Personat e përmendur ishin pjesëmarrës në Mukje.

⁵⁰ *Po aty*, F.260, V.1943, D.52, fl.25. Kronologjia e ngjarjeve 10 gusht 1943.

Siç dihet, Marrëveshja e Mukjes u denoncua si e papranueshme nga ana e PKSh. Më 8 gusht 1943, E.Hoxha, njoftonte komitetet qarkore të PKSH për të mos njohur vendimet e Marrëveshjes së Mukjes. Sipas tij, “Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacionalçlirimtare dhe disaprovohet nga KQ i Partisë...”⁵¹.

Shkaku i vërtetë i prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, nuk ishin kundërshtitë e vendimeve të saj me vijën nacionalçlirimtare, por se vendimet e saj binin në kundërshtim me synimet e PKSH për marrjen e pushtetit politik hap pas hapi që gjatë luftës. Ndaj, për udhëheqjen e PKSH, ishte e papranueshme ndarja e udhëheqjes së luftës me Ballin Kombëtar (kujto: Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë ishte organ për drejtimin e luftës që kishte përbërje të barabartë nga forcat politike).

E. Hoxha u pozicionua si kundërshtar i vendosur i bashkëpunimit me nationalistët e Ballit Kombëtar. “Ata që s’na kuptojnë – shprehej ai - kur këto i vënë gurë rrotës, ne s’ju puthim gjunjët, por ja heqim kokës. Emrin e partisë s’e përlyejmë”⁵².

Në mënyrë të natyrshme, Ymer Dishnica nuk mund ta pranonte lehtë denoncimin dhe hedhjen poshtë të Marrëveshjes së Mukjes. Prandaj, ai ngulmonte, në mënyrë të përsëritur se, “vendimi për të mos e njohur Marrëveshjen e Mukjes, qe një bombë për ne”⁵³.

Duke i bërë një “apologji” të vërtetë Marrëveshjes ai sqaronte: “Shtroheshim në tryezë për bashkim e të mos pranonim as edhe caktimin e një Komiteti të përbashkët të përkohshëm (KSHSH), komitet, në të vërtetë marrëveshjeje dhe koordinimi, atëherë ç’fuqi reale i jepnim parimit të bashkimit. Në qoftë se pranohej Marrëveshja, sigurisht do të sanksionohej me një “proklamatë të përbashkët” përndryshe do të dilnin në popull fjalë bashkimi sipas qejfit të njerit ose të tjetrit”. Dhe më tej vazhdonte: “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, si në vendimet që u morën si në diskutimet që u bënë, nuk ishte gjë tjetër, veçse një komitet koordinimi e marrëveshjeje, pa prekur aspak independencën e organizatave, të shtabeve e të çetave ...”⁵⁴

⁵¹ *Po aty*, F.14, V.1943, D.11, fl.13. Qarkore e Komitetit Qendror të PKSH, firmosur nga Shpati (pseudonimi i E.Hoxhës), 8 gusht 1943.

⁵² *Po aty*, F.20, V.1943, D.2, Fl.25. Letër e E.Hoxhës dërguar qarkorit të Korçës.

⁵³ *Po aty*, fl. 23. Letër e “Shafingos” (Ymer Dishnica) për Tarasin, 14 gusht 1943.

⁵⁴ *Po aty*.

Prishja e Marrëveshjes së Mukjes, nga udhëheqja e PKSH, përbënte një tradhti kombëtare, sepse minoi bashkimin e gjithë shqiptarëve në luftë kundër pushtuesit. PKSH mendoi e veproi vetëm për vendosjen e pushtetit komunist, si të vetmin pushtet në Shqipëri. Historiografia komuniste e ka trajtuar këtë qëndrim të PKSH si “veprimtari konsekuente e të vendosur, për të bindur shqiptarët, të pranonin vetëm programin e saj, që, sipas saj, ishte më i drejtë për të larguar nga rruga e gabuar njerëzit e mashtruar nga propaganda “demagogjike” e Ballit Kombëtar”⁵⁵. Kjo historiografi ka mënjanuar, në mënyrë të qëllimshme, faktin e pamohueshëm të konfrontimit të forcave politike, pas denoncimit të Marrëveshjes së Mukjes, për të mos “njollosur” emrin e PKSH, shkaktare e këtij konfrontimi

Është një kategori historianësh që e konsiderojnë prishjen e Marrëveshjes së Mukjes thjesht një moment intolerance të PKSH, për të marrë të gjithë pushtetin në duart e saj. Përgjegjësinë e PKSH për prishjen e Marrëveshjes, këta autorë, e shkarkojnë mbi të dyja forcat politike, si të PKSH, ashtu dhe të Ballit Kombëtar, sepse, sipas tyre, “as njëra dhe as tjetra nuk ishin të gatshme të përballonin sfidën e Mukjes”⁵⁶. Për më tepër, bëhen paragjykime sipas të cilave “as njëra dhe as tjetra nuk ishin të afta ta zbatonin”⁵⁷ (marrëveshjen – M.D.).

Të paragjykos dhe të shtrembërosh në mënyrë të tillë rrjedhën e procesit historik, për të mohuar përgjegjësinë e një force politike, është pak të thuash mosnjohje, por një përpjekje për të fabrikuar “argumente”, për të bërë propagandë e trajtim voluntarist të historisë.

Qëndrimin e PKSH për dënimin e Marrëveshjes së Mukjes e adoptoi edhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar i cili u mbledh në Konferencën e Dytë nacionalçlirimtare, më 4-8 shtator 1943, në Labinot të Elbasanit. Duke e konsideruar Marrëveshjen e Mukjes “si një rrezik serioz për ndarjen e pushtetit”, Konferenca II Nacionalçlirimtare vuri si kusht të domosdoshëm për Ballin Kombëtar heqjen dorë nga propaganda antikomuniste, për t’iu bashkuar Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ky kusht

⁵⁵ Shyqyri Ballvora, *Zhvillimet politike në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (7 prill 1939-29 nëntor 1944)*, Tiranë: “Dituria”, 2004, f. 173-174.

⁵⁶ Xhelal Gjeçovi, *Pushtimi gjerman në Shqipëri 2 shtator 1943-29 nëntor 1944*, Tiranë: “Botimpex”, 2005, f. 49-50.

⁵⁷ *Po aty.*

nënkuptonte që Balli Kombëtar të vihej nën ombrellën e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në luftën kundër pushtuesit.

Atë që PKSHE kishte shpallur më 8 gusht, Konferenca II Nacionalçlirimtare e konfirmoi, për t'i dhënë legjitimitet vijës politike të PKSHE, si drejtuese e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe kjo e fundit si maskë e PKSHE.

Në Konferencë u fetishizua roli i këshillave nacionalçlirimtare në bashkimin e popullit në luftë. Ato u shpallën si të vetmet organe pushteti që duhej të ekzistonin dhe të njiheshin si "të vetmet organe të pushtetit në Shqipëri", mbasi këshillat përfaqësonin popullin. Balli Kombëtar u trajtua në Konferencë si një organizatë rreth të cilës po grumbulloheshin të gjitha tendencat reaksionare të vendit.

Luftimet e Ballit Kombëtar nuk mund të anashkaloheshin, prandaj Enver Hoxha dhe diskutantë të tjerë u përpoqën t'i zhvlerësonin ato. Kështu u veprua për veprimet e Dervish Rexhepit e Rasim Babametos në Gjirokastër, për pjesëmarrjen e Hysni Lepenicës në luftën e Gjormit (janar 1943) atë të Isuf Luzajt në luftën e Selenicës, të Tefik Cëfirit në Mallakastër, të Jashar Cakranit etj.⁵⁸

E gjithë fryma mohuese dhe akuzuese në Konferencë për Ballin Kombëtar, sjellja e "fakteve" përbënte platformën politike të PKSHE për qëndrimin ndaj tij, e për të mos pranuar bashkëpunimin me këtë organizatë. Sipas komunistëve, Marrëveshja e Mukjes nuk kishte asnjë vlerë por ishte një veprim aksidental dhe një rrëshqitje në pozitën e Ballit Kombëtar.

Në Konferencë, u shpreh mendimi, sipas të cilit, "Neve duhej të bënim me ta (ballistat) një afrim bashkimi, por të vinin ata në Luftën tonë Nacionalçlirimtare, të vinin ata në pozitën tonë"⁵⁹. Me fjalë të tjera, kërkohej eliminimi i identitetit organizativ e politik të Ballit Kombëtar, si forcë politike më vete.

Paniku që kishte mbërthyer disa diskutantë të Konferencës se, "Marrëveshja e Mukjes do të fshinte të gjithë luftën tonë të deritanishme", kishte të bënte me frikën e ndarjes së pushtetit, gjë që binte ndesh me qëllimin politik të PKSHE për marrjen e pushtetit me

⁵⁸ *AQSH/AP*, F.40, V.1943, D.12. Procesverbal në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare, në Labinot, 4-8 shtator 1943. Nga diskutimi i Enver Hoxhës, f. 36.

⁵⁹ *Po aty*, f. 172. Diskutimi i Sejfulla Malëshovës.

forcën e armëve. Siç dukej komunistët e ndjenin veten të fuqishëm në raport me nacionalistët. Prandaj u shtrua alternativa që “ne do ta shtrëngojmë Ballin ose të pranojmë luftën tonë ose t’i ndajmë lakrat njëherë e mirë”. Për të arritur këtë synim bëhej thirrje “për të goditur me tërë fuqinë tonë, politike dhe ushtarake, këdo që do të na pengojë, do t’i biem me gjithë peshën tonë të rëndë, me gjithë peshën e luftës së Ushtrisë Nacionalçlirimtare”⁶⁰.

Në Rezolucionin e Konferencës së Labinotit u bë një vlerësim i deformuar i situatës politike të brendshme. Mobilizimin e të gjitha forcave të brendshme, në një front të përbashkët luftime kundër pushtuesit, rezolucioni i konferencës e quante të pamundur sepse e konsideronte grumbullim me reaksionin. Balli Kombëtar u konsiderua si një organizatë rreth së cilës ishin grumbulluar “gjithë plehrat e Shqipërisë, gjithë reaksioni”⁶¹. Që në atë kohë termi “reaksion” mori kuptimin kundërshtar politik i komunizmit, më vonë do të përfshinte të gjitha rrymat politike jashtë Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Një vlerësim i tillë për Ballin Kombëtar, në atë kohë, ishte tepër i pasaktë sepse ai ishte hedhur në veprim kundër okupatorit, duke iu përgjigjur edhe vendimit të Mbledhjes së Mukjes, për të realizuar bashkëpunimin e organizuar me Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, bashkëpunimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare me Ballin Kombëtar do të shtrohej në kondita krejt të tjera, me kushte të njëanshme dhe asgjësuese për Ballin Kombëtar.

Këto kushte ishin:

1) “Të njiheshin këshillat nacionalçlirimtare si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri”. Ky kusht, i shtruar në situatë-lufte, do të thoshte mënjanimi i forcave të tjera politike dhe përjashtim de facto i çdo bashkëpunimi me këto forca.

2) Të pastroheshin radhët e Ballit Kombëtar nga spiunët dhe kriminelët. Vënia e këtij kushti bëhej me qëllim inkriminimi të Ballit, si rrjedhojë sajohej alibia për eliminimin e anëtarëve të tij duke justifikuar veprimin si “vrasje të spiunit dhe të kriminelit”.

3) Të hiqej dorë nga propaganda antikomuniste, që është në kundërshtim me interesat e luftës së sotme dhe me parimet demokratike. Duke vënë këtë kusht, Lëvizja Nacionalçlirimtare konfirmonte haptazi

⁶⁰ *Po aty.*

⁶¹ M.Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian...*, f. 418.

rolin dominues të PKSH në këtë lëvizje. Në të vërtetë një kërkesë e tillë ishte absurde, sepse ajo ishte tejkaluar me arritjen e Marrëveshjes në Mukje, pasi propaganda e të dyja forcave politike, pas Mukjes, do të bëhej në funksion të bashkëpunimit dhe jo kundër njëra-tjetrës.

Vlerësimi i gabuar i situatës politike në Shqipëri vazhdoi edhe pas Konferencës së Labinotit. Që të nesërmen, më 9 shtator 1943, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e vlerësonte situatën “prag i një kryengritjeje të përgjithshme që është në rend të ditës”⁶², një moment i favorshëm për të vendosur pushtetin e këshillave nacionalçlirimtare. “Kryengritja e përgjithshme”, në konceptin komunist, do të drejtohej kundër të gjithë atyre forcave që do të pengonin vendosjen e këtij pushteti dhe, në radhë të parë, kundër pushtetit të Ballit, të vendosur në zonat e liruara nga ana e tij.

Kapitullimi i Italisë fashiste, më 8 shtator 1943, inkurajoi Lëvizjen Nacionalçlirimtare të vendoste pushtetin e saj dhe për ta paraqitur atë para aleatëve si të vetmin pushtet në Shqipëri, me të cilin mund të zhvilloheshin bisedime. Situata ishte e dyzuar Shqipëria ishte në prag të një kryengritjeje të përgjithshme, me dy synime: për të zotëruar situatën pas kapitullimit të Italisë dhe të zhvillonte luftën për pushtet, e cila përbënte pragun e një lufte civile.

Gjatë muajit shtator 1943, qëndrimi i vendosur i Lëvizjes Nacionalçlirimtare për marrjen e pushtetit, ndikoi edhe në qëndrimin ndaj ushtrisë kapitulluese italiane. Jo në pak raste u gjet gjuha e kompromisit me ta, për të goditur forcat politike shqiptare të cilat konsideroheshin “reaksionare apo bashkëpunëtorë të pushtuesit të ri”.

Zhvillimi i ngjarjeve gjatë 14 shtatorit 1943, në Grehot të Gjirokastrës, tregoi se ishte një marrëveshje e fshehtë midis forcave partizane me ushtrinë italiane, në planin e tyre kundër ballistëve. Në kulmin e veprimit luftarak të forcave balliste, të udhëhequr nga Hysni Lepenica, për të çarmatosur ushtrinë italiane të garnizonit të Grehotit, “një komision partizanësh - shprehej Bonomi - hyri në kampin tonë, duke na ofruar ndihmë kundër nacionalistëve” por që nuk u pranua nga gjenerali italian sepse ishte përcaktuar qartë rruga e daljes e cila do të ishte e hapur në zonën e okupuar nga nacionalistët⁶³.

⁶² *Po aty*. Mbledhja e datës 9 shtator 1943. Diskutimi i Sejfulla Malëshovës.

⁶³ Giovanni Bonomi, *Albania. La tragica marcia dei militari italiani di Tepeleni e Argirocastro a Santi Quaranta*, f. 81.

Drejtesit komunistë në Gjirokastrë kishin rënë në ujdi me drejtesit e Divizionit italian, të cilët prisnin urdhër nga Komanda e lartë e saj që t'u dorëzoheshin partizanëve⁶⁴. Rrjedhojë e këtij kompromisi në fushën e luftimeve në Grehot, ishte rënia në krah të komandantit Hysni Lepenica e 33 dëshmorëve atdhetarë shqiptarë. Me cinizëm historianët komunistë e përflasin këtë ngjarje, duke u shprehur se, “me këta “martirë”, me këtë “luftë”, si kofini pas të vjelit, Balli u lavdërua me zhurmë të madhe”⁶⁵.

Kompromisi iu propozua divizionit italian “Firence”, që të ndryshonte drejtimin e lëvizjes, nga Dibra drejt Perëndimit, për të shmangur çarmatimin e tij nga forcat e Parisë së Matit⁶⁶.

Popullsia e Matit, që kishte të freskët masakrat italiane të muajit gusht, u ndesh me forcat italiane që shoqëroheshin nga partizanët e Haxhi Lleshit. Sipas informacionit të Haxhi Lleshit, “gjendja ishte kritike”. U vranë 15 veta nga ata që vinin për plaçkë (fshatarë që sulmonin italianët – M.D.) prej vullnetarëve tanë një; prej italianëve: një kolonel dhe 4 të tjerë në gjendje të rëndë”⁶⁷.

Gatishmëria e divizionit “Firence”, për të bashkëpunuar me forcat e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, u shfrytëzuan nga forcat partizane të Haxhi Lleshit, gjatë sulmit, fillimisht mbi Krujën dhe pastaj mbi Tiranën, ku forcat gjermane nuk ishin të shumta⁶⁸.

Sulmi i partizanëve në Krujë ishte konceptuar si një veprim për të larë hesapet me kundërshtarët politikë, në radhë të parë, me Abaz Kupin⁶⁹ për rolin e tij në Mukje. “Kruja duhet të sulmohet prej forcave tona dhe italianët t’ju ndihmojnë, pse atje s’ka gjermanë, por ka vetëm shqiptarë”⁷⁰, urdhërohej Haxhi Lleshi. Qëllimi është i qartë: luftë civile për marrjen e pushtetit.

⁶⁴ *AQSH/AP*, F.17, V.1943, D.12, fl.49. Letër e Kaçiatorit (Bedri Spahiut), dërguar “Laskës”, 12 shtator 1943.

⁶⁵ Sh. Ballvora, *Zhvillimet politike në periudhën...*, f. 200.

⁶⁶ *AQSH/AP*, F.49, V.1943, D.13, fl.9. Letër e Mustafa Kaçaçit, dërguar E.Hoxhës, 15 shtator 1943.

⁶⁷ *Po aty*, D.28, fl.7. Informacion i Haxhi Lleshit, 14 shtator 1943.

⁶⁸ *Po aty*, F.41, V.1943, D.9, fl.14. Urdhër i Komandës së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, drejtuar Haxhi Lleshit, 18 shtator 1943.

⁶⁹ *Po aty*, D.13, fl.8. Raport i Mustafa Kaçaçit drejtuar Shtabit të Përgjithshëm, 8 shtator 1943. Aty thuhej: “Bazi ka marrë një letër prej Tirane, ku porositet me pas kujdes, se komunistët kanë vendos me e vra”.

⁷⁰ *Po aty*.

Vendimi, për të vendosur gjithkund vetëm pushtetin e këshillave nacionalçlirimtare, doemos, do të çonte në krijimin e situatave të tilla, që shqiptarët të luftonin kundër njeri tjetrit, pra në luftë civile. Për t'i shpëtuar përgjegjësisë së pasojave që do të kishin urdhra të tilla, që çonin në konfrontimin midis shqiptarëve, Shtabi i Përgjithshëm bënte shënimin: "Të ruhet msheftësia e këtyre letrave, karakteri i të cilave është shumë konspirativ"⁷¹.

Propaganda e PKSH, gjatë shtatorit 1943, për ta paraqitur Ballin Kombëtar si organizatë tradhtare, bashkëpunëtore të pushtuesit, erdhi duke u rritur deri në shpalljen e direktivës së asgjësimit ushtarak të tij.

Gjatë ditëve të para të tetorit 1943, në të gjitha direktivat e udhëheqjes së PKSH, thuhej hapur e drejtpërdrejtë që, "veprimet ushtarake duhej të ishin vendimtare, asnjë hezitim, ndryshe e kemi të humbur (është fjala për pushtetin – MD) në qoftë se veprojmë me zemër prej murgeshe. Neve vemi drejt likuidimit të Ballit dhe jo bashkimit me të"⁷² etj. Lufta civile, që kishte shpallur PKSH e kishte vënë vendin përpara një katastrofe kombëtare. Prandaj, udhëheqja e Ballit Kombëtar e konsideronte të nevojshme një "pezullim" të veprimeve të forcave balliste, me shpresë se do të sqarohet njëherë e mirë qëndrimi i PKSH ndaj nacionalistëve. Megjithatë, PKSH nuk u ndal në rrugën e saj të vendosur, për asgjësimin e kundërshtarëve politikë të saj. Madje, udhëheqja e saj ndjente kënaqësi, kur kuadrot e saj raportonin se, "kanë qenë goditjet tona të forta që e shtynë Ballin Kombëtar të hidhej në krahët e gjermanëve. Qenia e tij u vu në rrezik. E vetmja rrugë shpëtimi për ta është që të hyjnë nën flamurin gjerman"⁷³.

Në fund të tetorit 1943, veprimet e luftës civile ishin në rend të ditës. "Lufta me bandat e Ballit është në urdhër të ditës, - raportonte Koçi Xoxe. Përveç goditjeve që iu dhamë po i ndjekim këmba-këmbës për shfarosje. Po për luftën me gjermanët pothuajse hiç"⁷⁴.

⁷¹ *Po aty*, D.9, fl. 14. Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për Haxhi Lleshin, 18 shtator 1943.

⁷² *Po aty*, F.14, V.1943, D.11, fl.35. Direktivë e KQ të PKSH, dërguar Muzhikut (Liri Gega) dhe për veprim gjithë komiteteteve qarkore të partisë, 1 tetor 1943.

⁷³ *Po aty*, F.14, V.1943, D.31, fl.2. Letër e Fortunës (Naxhie Dume), drejtuar Komitetit Qendror të PKSH (tetor 1943).

⁷⁴ *Po aty*, D.28, fl.11. Letër e Trashit (Koçi Xoxe) dërguar Tarasit (E. Hoxha) 30 tetor 1943.

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH dërgoi forca partizane në Dibër për të mbështetur luftën e formacioneve partizane të vendit kundër forcave nacionaliste ose “reaksionarëve”. Midis të tjerash, partizanët e nisur për në Dibër, kishin marrë porosinë të vepronin të pavarur nga batalioni i Dibrës, për të mos kompromentuar këtë të fundit në luftën kundër “reaksionarëve”⁷⁵. Pra, “reaksionarët” të goditeshin nga forcat partizane të dërguara.

Në muajt e fundit të vitit 1943, lufta civile u shtri në Berat, në Libohovë, në Zhëllimë dhe Cacabezë⁷⁶. Ndërsa, Brigada II partizane e kishte pasur të vështirë në operacionin për spastrimin e “reaksionarëve” (ballistëve) në zonën e Çermenikës, në fillim të dhjetorit 1943.

Në dhjetor të vitit 1943, lufta kundër “reaksionit” do të përfshinte jo vetëm atë kundër Ballit Kombëtar por dhe atë kundër Legalitetit, një forcë politike e krijuar pas largimit të Abaz Kupit nga Lëvizja Nacionalçlirimtare.

Lufta kundër gjermanëve, nuk mund të kishte efektivitetin e duhur në kushtet e luftës të forcave politike shqiptare për pushtet. Situata politike në Shqipëri, e cila rrëshqiti drejt luftës civile, i vuri në pozitë të vështirë të gjitha rrymat politike jashtë Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

S u m m a r y

THE POLITICAL SITUATION IN ALBANIA (JUNE-DECEMBER 1943)

During the second half of 1943, in political and military terms, the Italian occupation forces in Albania were going through a general crisis. The crisis had also involved the social and political classes in Albania. The increased resistance to the occupation forces made the latter intensify the violence against Albanians as the only means to subdue them. The confrontation between Albanians and the occupying army had brought Albanians together fighting in an anti-Italian war front. In this context, the political forces of the Albanian resistance were trying to collaborate in order to fulfill their primary goal, the liberation of the country. Although there were such favorable circumstances for an organized war against the invader, the political situation took another direction that undermined the Albanians' union around one single goal, namely the liberation of the country.

⁷⁵ *Po aty*, D.4, fl.16. Letër e Shtabit të Përgjithshëm për Haxhi Lleshin, 2 nëntor 1943.

⁷⁶ *Po aty*, D.31, fl.22, D.37, fl.10; D.33, fl.4.